



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 14.3.2019, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Andin Hoti, Salih Zyba, Danush Ademi dhe Lutfi Zharku.

Munguan: Etem Arifi dhe Sergjan Mitroviç.

Të ftuar nga MBPZHR: Dijana Zhiviq, ministre, Kapllan Halimi, sekretar i përgjithshëm, Ekrem Gjokaj, u.d. i kryeshefit të AZHB-së, Albana Zeqiri, Linda Krasniqi dhe Milena Aksiq.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e dt.12.2.2019 dhe 22.2.2019;
3. Informimi i komisionit, lidhur me grantet e Ministrisë së Bujqësisë, e ftuar ministrja;
4. Informimi i komisionit rreth punës së grupeve punuese për projektligjet në procedurë të komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës, e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Fillimisht, **Salih Zyba** kërkoi që në këtë mbledhje të diskutohet për gjendjen e hidrocentraleve, e më pas të ftohet edhe ministri i MMPH-së dhe KPMM-ja. **Kryetari** propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, pasi që sot nuk ka material bazë për diskutim. **Ganimete Musliu**, pyeti se a do të ftohet ministri i MMPH-së, vetëm për hidrocentrale, duke e ditur se ka edhe probleme të tjera mjedisore dhe përmendi djegien e pyjeve në javën e fundit.

Në fund, u pajtuan që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër, të ftohet ministri i MMPH-së dhe aktorët e tjerë, ku do të diskutohen këto shqetësime dhe paraprakisht të kërkohet një raport.

Në fund, kryetari konstatoi se komisioni, me 8 vota për, miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të komisionit nga mbledhja e dt. 12.2.2019 dhe 22.2.2019

Kryetari konstatoi se me 8 vota për, miratohen procesverbalet e mbledhjeve: 12.2.2019 dhe 22.2.2019, me përmirësimet në procesverbalin e datës 22.2.2019 nga deputetët: **Andin Hoti**, "propozoi që në lidhje me grantet të ftohet kryeshefi i Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë" dhe **Salih Zyba** "refuzoi propozimin që rreth problemit të granteve të ftohet kryeshefi i AZHB-së, por përfaqësuesi, përkatësisht ministri i MBPZHR-së".

3. Informimi i komisionit, lidhur me grantet e Ministrisë së Bujqësisë, e ftuar ministrja

Kryetari, fillimisht e uroi ministren për detyrën e re dhe e falënderoi për gatishmërinë për të raportuar në komision dhe tha se është kërkuar një raportim nga MBPZHR, mirëpo është shkarkuar ministri i mëparshëm dhe zëvendësministrat nuk kishin mandat të autorizuar për raportim. Arsyeja për raportim është puna e ministrisë në përgjithësi dhe disa indice nga disa media për keqpërdorimet e mundshme të disa fondeve të kësaj ministrie. Duke kërkuar mirëkuptimin e deputetëve për kohën e shkurtër të ministres, për shkak të agjendës së saj, ia dha fjalën asaj.

Ministrja e MBPZHR-së, Dijana Zhiviq, në fillim i falënderoi për ftesën dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar në mënyrë transparente me komisionin. Ajo tha se i vjen keq që në shumicën e pyetjeve nuk mund të japë përgjigje, pasi nuk ka qenë ministre gjatë asaj periudhe dhe shumica e pyetjeve kanë të bëjnë me atë periudhë, por pa dallim, ministria do të japë përgjigje. "Më lejoni që gjatë kësaj periudhe, prej kur jam ministre, të shfrytëzoj rastin që të njihem me punën e ministrisë. Aktualisht, po punojmë në finalizimin e programit për zhvillimin rural 2019. Këtë vikend do të mbajmë tryezën e rrumbullakët me të gjithë ekspertët e Ministrisë së Bujqësisë, për të finalizuar këtë program. Mendoj se deri në fund të javës së ardhshme do të jemi në gjendje të publikojmë programin për zhvillim rural 2019. Po ashtu, jam në dijeni se ka ardhur deri te vonesa e disa ligjeve dhe para deputetëve premtoj se këto ligje do të procedohen shpejt, si ligji për pyjet, ligji për ushqimin, gjuetinë, bujqësinë dhe zhvillimin rural".

Ndërsa, për të raportuar për çështjen e granteve, ajo tha se këtu janë: sekretari i përgjithshëm, drejtori i AZHB-së dhe 2 ekspertë, që merren me projekte të zhvillimit rural.

Kryetari, tha se e mirëkuptoj ministren, por sekretari, me përvojën në këtë ministri, shpreson se do të japë përgjigje të plota.

Sekretari i MBPZHR-së, Kapllan Halimi, tha se në vitin 2008 është hartuar një program në MBPZHR për pagesat direkte, pas debateve dhe ekspertizave të shumta që ka pasur. Në vitin 2018 kemi shtuar 2 masa: masa për zona më pak të zhvilluara, ku kemi marrë një pilot rajon, për të parë suksesin dhe është fokusuar në fermerët e vegjël apo "fermerët vetëekzistencial". Sipas regjistrimit të vitit 2014, në Kosovë ekzistojnë rreth 130 mijë ekonomi familjare bujqësore, ndërsa si ministri, përkrahim në programe bujqësore 30-35 mijë ekonomi familjare bujqësore, ku mbi 76 % të tyre nuk përkrahen. Më tej, theksoi se për këtë arsye, pas një dekade të përkrahjes së fermerëve të mesëm dhe të mëdhenj, kemi menduar të bëjmë një riverifikim, duke kyçur edhe fermerët e vegjël, që është shumica e fermerëve që të kenë një përkrahje nga institucionet për t'iu mundësuar atyre të kalojnë nga një nivel vetëekzistencial, ku produktin e tyre ata e përdorin për konsum shtëpiak apo për shitje dhe nuk kanë kapacitete tregtare ta plasojnë në treg. Besojmë se programi është i suksesshëm dhe për këtë kemi bërë disa analiza profesionale me Universitetin e KENT-it, Institutin e Lajbniz-it, me përkrahjen financiare të FAO-s, ku i kemi vërtetuar tezat tona të programit. Këtë vit kemi menduar që të jetë në gjithë territorin e Kosovës, pasi janë mbi 76 % të fermerëve të regjistruar që nuk marrin përkrahje shtetërore dhe këta e përbëjnë një konglomerat të punësimit dhe ne duhet t'i përkrahim që të mundohemi t'i ngremë në një shkallë më lartë në "gjysmë-vetëekzistencial" apo "gjysmëkomercial", që ata të kenë mundësinë e shitjes së produktit të tyre.

Risia tjetër ka qenë në infrastrukturën rurale. Ne, çdo ditë, bisedojmë për produktet vendore në treg dhe për të konkurruar me një kompani të madhe, duhet t'i kemi të përgatitura bizneset tona, të konkurrojnë ato rajonale apo evropiane, që kanë pushtuar tregun tonë. Për këtë arsye, kemi

vendosur një pilot-program për mbështetjen e bizneseve të mëdha, me logjikën e dyfishtë: të kemi fuqizim të produktit tonë në treg dhe e dyta, që bizneset e mëdha të punojnë me bizneset e vogla, ku produkti i bizneseve të vogla të ketë një treg të sigurt.

Në lidhje me pretendimet mbi bazën e një artikulli në media, ai tha se ka sjellë një raport dhe për këtë janë në proces gjyqësor dhe do të sqarohen të gjitha çështjet e ngritura nga ky artikull. Në fund, ai shtoi se në vitin 2018, Ministria e Bujqësisë i ka tejkaluar pesë lloje të auditimeve: tre për performancë dhe dy për rregullsi.

Liburn Aliu, së pari i uroi ministres punë të mbarë dhe tha se ne nuk duhet t'i shtrojmë pyetje asaj, por shpresoj se ajo do të bëjë ndryshim në këtë ministri, që është shumë i nevojshëm, pasi që kjo ministri ka degraduar, në vazhdimësi, ndërsa degradimi më i theksuar ka qenë në kohën e ish-ministrit. Në vazhdim, ai shtroi pyetje, duke u ndërlidhur me diskutimin sekretarit të ministrisë “se po orientohemi kah pronarët e vegjël”, mirëpo ai tha se po ndodh e kundërta dhe kemi gjithnjë e më shumë pronarë të mëdhenj, të tokave që kanë qindra hektarë dhe ka filluar kthimi i një lloj feudalizmi dhe këta subvencionohen nga shteti, ndërsa ata të vegjlit marrin pak. Në projektin për infrastrukturë rurale, janë 4 konsorciume që kanë fituar nga 2 milionë € dhe secili prej këtyre konsorciumeve e ka gati të njëjtin pronar, pothuajse në të gjitha kompanitë. Pra, një pronar kompanie me disa kompani paralele, del e qet një konsorcium dhe fiton 2 milionë €. Problemi kryesor këtu janë 8 milionë €, të ndara për 4 konsorciume, në të cilat nuk janë shumë pronarë në ato katër konsorciume, por janë pak pronarë që marrin shumë. Ai shprehu habinë sesi i ka kaluar auditimit kjo çështje dhe duhet të hetohet nga prokuroria.

Besa Gaxherri, duke i uruar suksese ministres, tha se sukseset nuk do të jenë tuaja, por të qytetarëve, të shtresës më të mundimshme, që janë të përkushtuar të punojnë dhe të fitojnë ndershëm dhe shtoi se Kosova asnjëherë nuk ka pasur një ministër të denjë, sikurse do të duhej për këtë dikaster dhe shtoi se organi më kompetent që merret me monitorimin dhe mbështetjen e kësaj ministrie është ky komision. Në vazhdim, ajo e pyeti ministren: A e keni bërë prerjen nga puna e kaluar me pranim-dorëzimin e punës suaj? Sepse, ne kemi mjaft dyshime dhe argumente që në këtë ministri është keqpërdorur dhe abuzuar, andaj unë konsideroj që ju të keni sukses, duke mos u thirrur në të shkelurat që nuk kam qenë unë, pra është një procedurë që duhet të bëni prerjen e pranim-dorëzimit të punës. Për raportin, tha se nuk e kemi komplet dhe s'kemi lëndë për diskutim sot, pasi që kemi kërkuar sqarim për grantet e ministrisë, së paku për vitin 2019. Gjithashtu, ajo tha se nuk pajtohet me kohën e shkurtër të ministres në dispozicion të kësaj mbledhjeje.

Salih Zyba, pyeti ministren për raportin që ka ardhur në emër të sekretarit të MB-së: A e merrni përsipër përgjegjësinë për këtë, si dhe nga kush ministria e ka marrë detyrën, kur ka shkuar në ministri? Kush ka qenë personi i autorizuar që ka zëvendësuar ministrin paraprak? Ai, gjithashtu, pyeti edhe sekretarin në lidhje me raportin, a është duke u zhvilluar procedurë gjyqësore për rastin apo për shqetësimet që kanë qenë në opinion ? pasi që kërkesa jonë ka qenë sipas shqetësimeve të qytetarëve, për skandalin mediatik, ndërsa ju jeni përgjegjës me një raport të shkruar me fjalët “Argumentimi i të gjeturave nga shkrimi tendencioz”, pastaj “gazetari në mënyrë tendencioze”, pastaj “gazetari tendencioz”, dhe në fund “e gjithë arsyeshmëria është tendencioze dhe e shpikur”.

Salih Salihu, pyeti: A do të vijë ministria në Kuvend, për të na dhënë mundësinë që të paraqesim shqetësimet e fermerëve të Kosovës? Sepse, ish- ministri ka qenë vetëm një herë. Në vazhdim, ai tha se qëllimi i granteve dhe subvencioneve është për zhvillimin e bujqësisë dhe të ekonomisë së vendit dhe kjo duhet të jetë e matshme. Ne duhet ta dimë se ky investim a po kthehet në zhvillim ekonomik të vendit. Pajtohet që të jepen 1 milion për fermerët e mëdhenj që punojnë, por të përcillet puna e tyre dhe të dihet se apo shkojnë mjetet në destinimin e duhur dhe sa ndikon në rritjen e punësimit. Më tej, theksoi se ka fermerë të suksesshëm që dëshirojnë t'i zgjerojnë kapacitetet dhe mund të punësojnë punëtorë të rinj dhe të hapin ndonjë fabrikë për përpunimin e produkteve bujqësore dhe janë qindra fermerë të vegjël e dërgojnë prodhimin aty dhe kjo do t'i kontribuonte zhvillimit të vendit.

Ganimete Musliu, tha se nuk pajtohet me kohën e shkurtër të ministres, për mundësinë për të bërë pyetje, si dhe mënyrën si është thirrur kjo mbledhje. Sepse, në rend dite e kemi raportin e ministres

dhe s'kemi kohë të mjaftueshme për pyetje. Ministria, nëse nuk ka pasur kohë, është dashur të shtyhet kjo mbledhje ose të zëvendësohet me një takim njoftues të ministres me anëtarët e komisionit, e në një mbledhje tjetër, të bëjmë pyetje, për të cilat qytetarët janë duke pritur me muaj. Ajo kërkoi që mos të keqkuptohet, pasi që e kupton ministren dhe nuk kërkojmë asnjë përgjigje sot prej saj, duke e ditur kohën e shkurtër që ka marrë postin, të cilës i uroi punë të mbarë.

Danush Ademi, tha se për fermerët e vegjël, kriteret janë të rënda dhe vetëm fermerët e mëdhenj përfitojnë dhe shtoi se duhet të merren parasysh fermerët e komuniteteve, sepse, deri më tani, asnjëherë nuk janë përkrahur, sidomos komuniteti ashkali, në rrafshin e Dukagjinit.

Andin Hoti, pyeti: Kur do të finalizohet programi për vitin 2019 dhe kur do të fillojë faza e aplikimit, si dhe a janë paguar të gjitha subvencionet e vitit të kaluar, nëse jo, na tregoni afatin?

Ministrja Zhiviq, tha se do të punojë ndershëm dhe ministria do të punojë në mënyrë transparente, gjatë këtij mandati. Keni të drejtë të hidhërohemi për kohën e shkurtër, por shpresoj që në takimet e ardhshme do të jemi të gatshëm të kemi të gjitha përgjigjet, për secilin problem, theksoi ajo. Më te, ajo tha se këtu është sekretari i ministrisë, që profesionalisht mund të përgjigjet në të gjitha pyetjet tuaja. Për raportin, tha se duhet të rishikohet edhe një herë, pasi që është dërguar para marrjes së mandatit, kurse për pranim-dorëzimin e detyrës, tha se atë e ka marrë nga Kryeministri.

Sekretari Halimi, në vazhdim, iu përgjigj pyetjeve të deputetëve:

- Për raportin, tha se e kam dorëzuar te kryetari, ndërsa nuk kemi pasur autorizim për të ardhur në komision. Raporti është 6 faqesh, duke iu bashkëngjitur edhe gjithë argumentimi faktik mbrapa. **Kryetari** ndërhyri dhe tha se në shtojcë janë vetëm 5 certifikata të regjistrimit të bizneseve dhe një vendim i ministrit dhe nuk ka material tjetër.
- Do të jem mbrapa gjithë asaj që kam shkruar në raport, ndërsa nuk do të lëshohem më shumë, pasi që jemi në proces gjyqësor dhe gjykata do të vendosë se kush ka të drejtë.
- Ministria i ka dy ueb faqe, ajo e MBPZHR-së që e menaxhon Zyra për Informim Publik e Ministrisë dhe ajo e AZHB-së, të cilën e menaxhon stafi i agjencisë.
- Për programin për bujqësi dhe zhvillim rural, tha se është i përgatitur dhe është i gatshëm që nga nëntori 2018, por ministri i kaluar nuk ka dashur ta nënshkruajë në ditët e fundit të mandatit, ndërsa ministria e potencoi se deri në fund të javës së ardhshme do të publikohet.
- Vonesa në pagesat direktet ka pasur, për arsye se kemi pasur rritje në mbjelljen e grurit për 9 milionë € dhe për këtë arsye vonesat kanë qenë 1-2 muaj. Për projekte të zhvillimit rural, të gjitha procedurat janë brenda kontratës, nuk ka asnjë vonesë.
- Për kompensimin e dëmeve, si ministri, nuk ka fond të veçantë për kompensimin e dëmeve. Kryeministri e ka nxjerrë një vendim, vitin e kaluar, ku e ka marrë përsipër Qeveria, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, një mundësi të kompensimit lidhur me dëmet. Si ministri, ne kemi inkuadruar sigurimin në disa kultura bujqësore, në bashkëpunim me IFC-në e Bankës Botërore dhe i gjithë procesi është i gatshëm për implementim, për këtë vit.

Kryetari propozoi që në një prej mbledhjeve të ardhshme, të kërkohet raport nga MBPZHR, në lidhje me 4 milionë €, që u përmendën, pastaj për 4 konsorciumet, kush janë ato dhe si janë ndarë dhe cilat janë kriteret. **Besa Gaxherri**, kërkoi një raport zyrtar, të saktë, për vitin 2018, nga MBPZHR, me tabela dhe shifra konkrete, për programet, koston e benefitit, përfituesit. Pastaj edhe një analizë e përfitimeve, për 15 vite, të subvencioneve. Ndërsa, **Salih Zyba** shtoi se në raport duhet shtuar edhe për skandalin e përdorimit të veturave, pastaj edhe për 5 auditimet që u përmenden, të jenë pjesë e raportit, si dhe për ligjin për farëra, i cili është i rëndësishëm dhe të tregohet se në cilën fazë është dhe kur do të sillet në Kuvend.

Ekrem Gjokaj, u.d. i kryeshefit të AZHB-së, tha se për hir të korrektësisë, kanë qenë të paraparë 4 milionë €, mirëpo secili përfitues i ka përfituar nga 500 mijë € dhe 500 mijë € janë vetëfinancim. Pra është fjala për 2 milionë €, për projektet e infrastrukturës rurale. Ndërsa, sa i përket kërkesës për raport, ne i kemi për secilën komunë, me përqindje, me numër të përfituesve dhe të aplikuesve, prej vitit 2014-2018. Pastaj, kemi raportin e gjelbër, që është i vetmi që bëhet në Ballkan, që i paraqet ndryshimet strukturore, në kuadër të sektorit prej viti 2005, me përqindje, bilanci i

furnizimit, sipërfaqja, prodhimtaria, rendimenti, bilanci tregtar. Të gjitha këto materiale, jemi të gatshëm t'ua sjellim, përfundoi Gjokaj.

Kryetari, në fund, i falënderoi për pjesëmarrjen, sekretarin Halimi dhe stafin e tij, për kohën dhe përgjigjet, ndërsa për herën tjetër kërkoi nga MBPZHR, që për secilin deputet, veç e veç, të dërgohen të gjitha këto materiale që u përmenden dhe të tjerat, sipas kërkesave të deputetëve në këtë mbledhje.

4. Informimi i komisionit rreth punës së grupeve punuese për projektligjet në procedurë të komisionit

Kjo pikë u shty për një mbledhje tjetër, pasi që grupet e punës janë duke vazhduar punën.

5. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi deputetët për vizitën që komisioni do të realizojë në Mal të Zi, prej datës 17-20 mars 2019, me ç' rast do të zhvillojë edhe takime me komisionin homolog në Kuvendin e Malit të Zi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Muharrem Nitaj